Masat e pergjithshme qe i kemi ndërmarr për reduktimin e kostove:

- Shpenzimet operacionale - kemi ndërmarr masa që shpenzimet e mirëmbajtjes ti ulim në masë optimale , dhe ato janë zvogëluar për muajin mars dhe prill në shumë prej 7,672.38 euro
- Pagat e punëtorëve- Ne baze të rekomandimit të Këshillit Ndërministror për ujëra për zbutjen e efekteve financiare nga situata COVID-19 ,kompania ka marrë vendim, që të llogaritet pushimi vjetor i pashfrytëzuar i vitit 2019 nga punëtorët e kompanisë gjatë kohës së pandemisë.
- Kompensimi për shujtën ditore gjate kohës se pushimit vjetor dhe mungesës ne pune për shkakë të pandemisë nuk do të paguhet. Nga kjo do të kursehet ne emër të pushimit vjetor për 2019 shuma : 7,252.00 € ,ndërsa për vitin 2020 ne emër te shujtës do te kursehen : 17,240.65 €.

- Shpenzimet tjera- me masat e ndërmarra i kemi ulur për periudhën mars-prill/2020 ne shumë prej 3,630.00 €

Masat tjera të kompanis per tejkalimin e situates :

- Duke u bazuar ne raportin e peformances operative dhe financiare per periudhen janar prill/2020 dhe vështirësit qe i kemi hasur ne mund te konstatojm qe ne periudhen maj/dhjetor 2020 duhet ti arrim këto parametra :
 - Faturimin total në shum prej 370,000.00
 - Inkasimin total ne shum prej 430,000.00
 - Shpenzimet operativ 315,000.00
- Obligimet mujore te kompanis per periudhen ne vijim janë:
 - Obligimi ndaj KEK -ut shenime kontabël më 30.4.2020 eshte 1,238,571.48nese arrihet marreveshje me KEK-un per programim te borgjit per 20 vite, atëhere kësti mujor eshte 5,160.00
 - Obligimi ndaj ATK-s 502,221.16 nese arrihet marreveshje për 2 vite ,atehere kësti mujor do jete 20,925.88
 - Obligimi i papaguar i KEDS-it shkurt/mars 2020 eshte 162,612.00 me marreveshje mirkuptimit te paguhet gjer më 31.12.2020 kësti mujor do jet 27,102.00
 - Obligimi ndaj kredis kësti mujor ne shum prej 1,360.00
 - Obligimi ndaj operatorëve tjer ekonomik shuma prej 499,448.80 duke llogaritur qe gjer më 31.12.2020do të paguhet, me marreveshje mirkuptimi ateher kësti mujor do të jete 40,000.00
 - Obligimi ndaj Huas nëse aprovohet sipas pakos emergjente të qeveris ne shum prej 450.000.00, kesti mujor është 75,000.00 euro
- Rekapitulim i obligimeve totale mujore .

- Obligimi ndaj KEK -----	5,160.00 €
- Obligimi ndaj ATK-s-----	20,925.88 €
- Obligimi ndaj KEDS-----	27,102.00 €
- Obligimi ndaj kredis-----	1,360.00 €
- Obligimi ndaj operatorëve ekon.----	40,000.00 €
- Obligimi mujor ndaj huas-----	75,000.00 €
- Shpenzimet operative mujore-----	315,000.00 €

Gjithësejt obligimet mujore -----	484,547.88 €

P.S: Planifikojm qe kthimi i këstit të kredisë te filloj nga janari i v .2021

3.1.6 Transaksionet kryesore të Kompanisë – TM1-2020

10 pagesat me te medha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret

NR.	Posting Date	Document No.	Vendor No.	Description	Amount
1	2/25/2020	NLB-P-00020127	FUR-01544	Raicommerce Construction	40,000.00
2	1/15/2020	PCB-P-00081850	FUR-01039	KEK - Bunari I	24,745.22
3	2/13/2020	NLB-P-00019993	FUR-01039	KEK - Bunari I	24,115.42
4	1/13/2020	NLB-P-00019782	FUR-01664	Media Tech	15,500.00
5	3/3/2020	NLB-P-00020174	FUR-01375	Multi Business Group	13,000.00
6	1/31/2020	PCB-P-00083662	FUR-01375	MBG	13,000.00
7	3/4/2020	BPBPZNPOS-000455	FUR-01033	Pag.pjeses se fat.0043 Burimi-Com sh.p.k.	8,923.27
8	2/5/2020	PCB-P-00083666	FUR-01375	MBG	8,500.00
9	3/3/2020	NLB-P-00020181	FUR-01357	Auto Buqa	8,380.00
10	1/14/2020	BPBPZNPOS-000291	FUR-01074	KEK - Banjë MA	7,877.92
					164,041.83

10 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM4 2019

Nr.	Posting Date	Document No.	Customer No.	Description	Original Amount
1	31.01.2020	NLB-P-00019042	KONS-0039879	SH.P.K "Invers" Zona Industriale	3,716.67
2	26.03.2020	NLB-P-00018852	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	7,778.68
3	13.02.2020	NLB-P-00019037	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	7,750.56
4	13.03.2020	NLB-P-00018857	KONS-0059600	Galeria Shopping Mall SH P K	3,870.46
5	31.03.2020	NLB-P-00018847	KONS-0037156	Sh.Mesme "Jeta e Re"	3,574.15
6	24.01.2020	NLB-P-00019146	KONS-0004044	Ajshe Bajram Maloku	2,288.56
7	26.02.2020	NLB-P-00019418	KONS-0019214	Sefer Ibro	1,724.60
8	21.02.2020	NLB-P-00019413	KONS-0029809	Sh.K.K Qendra e paraburgimit - Prizren	1,643.28
9	24.01.2020	PCB-P-00072009	KONS-0029809	Sh.K.K Qendra e paraburgimit - Prizren	1,488.39
10	13.02.2020	PCB-P-00078806	KONS-0029794	SPITALI I QARKUT HEMODIALIZA	1,440.08
Totali					35,275.43

IV. Shërbimet e përbashkëta në Departamentin e administratës

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marruar me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raportet e sektorëve të departamentit të administratës si raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore, zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë, aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për janar - mars 2020.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe Kryeshafi Ekzekutiv. Për Vendimet dhe Rekomandimet e dala në takimet e BtD dhe Komisionit të Auditimit janë njoftuar të gjithë zyrtarët dhe udhëheqësit e Kompanisë pas përfundimit të procesverbalit të takimit përkatës.
- Nga zyra ligjore është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Malishevës, Dragashit dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbauesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit. Nga gjysma e muajit mars procedimi dhe zhvillimi i lëndëve të përmbauesit privat është ndalur për shkak të pandemis covid-19.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu në shërbim të administratës janë lëshuar për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Vlerësimet të kryerjes së detyrave të punës për punonjësit e KRU gjatë vitit 2019 janë regjistruar në program gjatë këtyre tre muajve nga Zyrtarja për burime njerëzore.
- Janë bërë vazhdimet e kontratave të punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qene në afat për gjashtë muaj dhe një vite, dhe të punëtorëve që kanë pasur kontratën e pare të punës me mundësi të vazhimit, pas vlerësimit të kryerjes së detyrave të punës të bërë nga ana e udhëheqësve të sektorëve .
- Kane bërë shkëputje të kontratës me vetdëshirë dy punëtorë të Kompanisë nga data 01.01.2020: B. Zenelaj - Operator për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe N. Baraliu - Koordinator në sektorin e operativës dhe mirëmbajtjes në njësinë e Suharekës.
- Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporatave për vitin 2019 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : certifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi

emërimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2019, vendimet e Bordit për 2018, procesverbalet e Komisionit të Auditimit, deklarata e politikës së kompensimit, Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit, procesverbalet e komiteteve, plan-biznesi 2019, raporti vjetor 2019 dhe raportin mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2018 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren.

- Duke u bazuar në situatën e krijuar për shkak të COVID 19 dhe vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë situatë, Menaxhmenti i K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren, me datë 14.03.2020 formon SHTABIN EMERGJENT për mbarëvajtjen e shërbimeve esenciale me furnizim dhe cilësi të shërbimit me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit. Ky shtab do të jetë në dispozicion 24/7 h me qëllim të qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve për të gjithë konsumatorët, me theks të veçantë prioritet do të kenë sektori i shëndetësisë, sektori i sigurisë dhe sektori korrektues.

Nr	Llojet e pushimeve që janë shfrytëzuar nga punonjësit	Nr. i punonjësve
1	Pushim vjetor	101
2	Pushim mjekësor	26
3	Pushim pa pagës	2
4	Pushim lehonisë	2
5	Pushim për lindje të fëmijut	3
6	Pushimi mjekësor 70%	1

Konkurset: Janar – Mars -2020

Gjate këtyre tre muajve janë shpallur dhe rishpallur konkurset sipas tabelës së paraqitur. Konkurset janë publikuar pas kërkesës së njësisë kërkuese dhe aprovimit të kërkesës nga Zyrtari kryesor financiar dhe Kryeshafi Ekzekutiv.

Nr	Pozita e punes	Nr i k	Dita e shpalljes se konkursit	Njesija	
1	Operator në sistemin e GIS-it	1	09.01.2020	PRIZREN	
2	Automekanik	1	14.01.2020	PRIZREN	anuluar 12.02.2020
3	Laborant/e në sektorin e cilësisë së ujit të pijes	1	14.01.2020	PRIZREN	anuluar 07.02.2020
4	Teknik elekticist ITUZ	1	15.01.2020	PRIZREN	anuluar 12.02.2020
5	Teknik - Mekanik ITUZ	1	15.01.2020	PRIZREN	anuluar 12.02.2020
6	Punëtor fizik (I.T.U.Z)	6	15.01.2020	PRIZREN	
7	Punëtor- Receptionsiste ne (I.T.U.Z)	1	15.01.2020	PRIZREN	
8	Punëtor- Mirembajtës i jashtëm i objekteve dhe parkut ne (I.T.U.Z)	1	15.01.2020	PRIZREN	
9	Punëtor- Higjiene-Bife ne (I.T.U.Z)	2	15.01.2020	PRIZREN	
10	Punëtor- Furnizues ne (I.T.U.Z)	1	15.01.2020	PRIZREN	
11	Rishpallje Asistent i/e Labororit ITUZ	1	17.01.2020	PRIZREN	anuluar 12.02.2020
12	Rishpallje Asistent i/e Labororit ITUZ	1	06.03.2020	PRIZREN	
13	Rishpallje Laborant/e në sektorin e cilësisë së ujit të pijes	1	06.03.2020	PRIZREN	

PERSONELI – JANAR– MARS 2020

Muajt	Nr.i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	330		2		
Shkurt	331	1			
Mars	342	11			

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: MARS 2020

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	298	35	4	5	342
Numri i Punëtorëve në %	87.1	10.2	1.2	1.5	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	49	14.33	
MESHKUJ:	293	85.67	
TOTAL	342		

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: MARS 2020

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A							
KUALIFIKIMI							
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	36	45	1	216	43	1	342
Kualifikimi në %	10.53	13.16	0.29	63.16	12.57	0.29	100

Raport i numrit te punëtorëve përfshire edhe Bordin për Janar- Mars – 2020

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Total			
1	Janar	336	241	6	247	36	17	36
2	Shkurt	337	242	6	248	36	17	36
3	Mars	348	253	6	259	36	17	36

Aktivite e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë dhe Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për TM/1, 2020– Prizren

Në këtë TM-1 janë realizuar vizita në objektet e kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë vizituar të gjitha objektet në njësinë punuese në Prizrenit, si “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatore”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet e “40 Burimeve –I”, objekti dhe “40 Burimeve - II “ ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë takime me përfaqësuesin e firmës “SAP-Internacional sh.p.k” në Prizren e cila benë servisimin aparateve kundërzjarrit ku kemi ngecje për furnizim me aparate sipas kontratës, për shkaqe teknike të firmës nuk kemi mundur të bëjmë furnizim me aparate, dhe kemi kërkuar nga firma “SAP-Internacional sh.p.k” në Prizren të jetë më e përgjegjshme në përmbushjen e kontratës.

Gjatë TM-1 vazhdimisht kemi bërë kontrollimin e punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke realizuar punime në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit nëpër disa vende në qytetin e Prizrenit.

Gjatë kësaj periudhe të TM-1 janë realizuar vizita në objektin “Pusi i Atit” të njësisë punuese Suharekë ku gjendja e këtij objekti ka ndryshuar dukshëm duke intervenuar në rregullimin e rrethojave, rregullimin e portës hyrëse si dhe në pastrimin e hapësirës për rreth objektit.

Në këtë tremujor janë zhvilluar procedurat dhe kemi realizuar dezinfektim, dezinfektimin dhe deratizimin e të gjitha objekteve të kompanisë.

Në bazë të përgjegjësive dhe detyrave të punës me shkrim i jam drejtuar të gjithë përgjegjësve duke kërkuar për të gjithë punëtorët që punojnë në sportele, leximin e ujëmatësve, rojet, ekipet e kontrolles, zyret e përbashkëta , që të kenë kujdes për marrjen e masave mbrojtëse ndaj covid-19. Pas rekomandimit të IKSHPK-së dhe vendimit të Qeverisë së Kosovës për reduktimin e stafit punues kemi marr masa mbrojtëse për punëtorët që janë paraqitur në vendin e punës duke i furnizuar me dorëza dhe maska mbrojtëse.

Gjatë kësaj periudhe janë inspektuar të gjitha zyrat e punës, portoarkat si dhe të gjithë punëtorët e kompanisë për përdorimin e dorëzave dhe maskave mbrojtës ndaj covid-19.

Gjatë TM-1 janë realizuar vizita/kontrolla të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit edhe nga Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje gjatë 24/h, në të gjitha pikat e Njesisë së Prizrenit: 40 Burime, Mulliri i vjetër, rezervari Shpati, Bunari1, objektet e Drejtorisë, Kuogulatorët etj.

Në këtë tremujor çdo fund javë është bërë shpërndarja e njoftimeve për kujdestari javore të sektorit operativ, në të gjitha pikat ku kujdestarohen nga rojet.

Punëtorët e KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a. Prizren, duke i përfshirë edhe njësitë tjera punuese, të Malishevës, Suharekës dhe Dragashit, kanë përfunduar analizat për librezë sanitare në Institutin Kombëtar i Shëndetit Publik IKSHP – Prizren. Për shkak të Pandemisë COVID-19 të shfaqur edhe në Republikën e Kosovës, kemi mbetur pa u pajisur me librezë, pasi që IKSHP-ja tani janë të angazhuar vetëm në drejtim të marrjes së analizave për personat që dyshohet të jenë të prekur nga ky virus COVID-19.

Gjatë këtij TM-1 është marr iniciativë të zbrazet koagulatori dhe pastaj është pastruar në mënyrë të hollësishme dhe detajuar.

Gjatë kësaj periudhe në Sektorin e Sigurisë, nuk kemi pasur asnjë ndryshim në mbarëvajtjen e punës, puna ka vazhduar me orar të njëjtë dhe të plotë, me tre (3) ndërrime, për mos të rënë në kundërshtim me ligjin të gjithë rojtarët janë pajisur me masa mbrojtëse dhe formular për leje të qarkullimit për punë.

Është bërë dezinfektimi i objekteve të Kompanisë në të gjitha njësitë punuese, në atë të Prizrenit, Malishevës, Suharekës dhe Dragashit.

Objektet e dezinfektuara në Njësinë Punuese në Prizren janë:

Objektet dhe hapësira për rreth si dhe të gjitha zyrat e administratës së Hidroregjionit.

Objektet dhe hapësira për rreth si dhe të gjitha zyrat në Shadervan

Objekti i shërbimit operativ si dhe hapësira për rreth si dhe rruga deri te objekteve vjetra.

Objekti i rojës dhe hapësira për rreth të objektit te rezervuari i shpatit

Objektet, zyrat, depot të Mulliri i vjetër si dhe hapësirën për rreth objektit

Objekti i rojës te 40 burimet si dhe hapësira për rreth objektit.

Objekti i rojës dhe hapësira për rreth objekti i komunës-40 burimeve

Objekti, zyrat, si dhe hapësira për rreth objekteve te kuagulatoret.

Objekti i stacionit të pompave në Vermicë dhe hapësira përreth saj.

Në njësia punuese Suharekë janë dezinfektuar :

Objektet dhe të gjitha zyrat e administratës, depot, muret e jashtëm. automjetet, si dhe komplet hapësira për rreth objektit.

Objektet dhe hapësira për rreth objekteve te stacioni i pompave te “Pusi atit”

Objekti dhe komplet hapësira për rreth objektit te rezervuarët në “Baqevcë”.

Në njësia punuese Malishevë janë dezinfektuar :

Objektet dhe të gjitha zyrat e administratës, depot, automjetet, si dhe komplet hapësira për rreth objektit.

Objekti, zyra e rojtarit si dhe hapësira komplet për rreth objekteve në Banjë.

Në njësia punuese Dragash janë dezinfektuar :

Objektet dhe të gjitha zyret e administratës në Dragash janë dezinfektuar depot, automjetet, si dhe komplet hapësira për rreth objektit.

Dezinfektimi i objektit dhe hapësira për rreth objekteve te filtrat në Dragash.

Dezinsektimin, Deratizimin dhe Dezinfektimin në të gjitha objektet në Prizren. Suharekë, Malishevë dhe Dragash është monitoruar puna e tyre nga Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë dhe nga Shefi i sigurimit fizik të objekteve dhe administrator i rojeve.

PËRFAQËSIMI NË GJYKATA JANAR – MARS 2020

Muaji	Seanca përgatit ore	Seanca kryesor e	Seanca të shtyra	Ndërmj etësim	Vërejtje
Janar	/	1	1	2	
Shkurt	3	1	1	/	
Mars	/	/	5	/	
Totali	3	2	7	2	

Siç edhe shihet në tabelën lart, në këtë periudhë kohore kemi marrë pjesë në gjithsej **15 (pesëmbëdhjetë)** seanca gjyqësore prej të cilave **3 (tri)** seanca kanë qenë përgatitore, **2 (dy)** seanca kryesore, **7 (shtatë)** seanca janë shtyrë për shkaqe të ndryshme, **2 (dy)** seanca me ndërmjetësim.

TABELA PËR RAPORTET E PUNËS 2020
JANAR – MARS (TM1)

	Janar	Shkurt	Mars	Totali
Aprovime të pjesërishtme	10	7	3	20
Aktvendime në favor të Kompanisë	8	2	/	10
Aktvendime kundër Kompanisë	/	2	1	3
Me përfaqësues	4	/	2	6
Thirrje për seanca	1	4	/	5
Aktvendime urdhërohen debitorët	/	/	/	/
Korrigjime të Aktvendimeve	1	/	/	1
Aktvendime E.nr.	/	23	2	25
Aktgjykime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	1	/	1
Aktgjykime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime për Kallëzime Penale në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	/	/	1	1
Me ndërmjetësim	2	/	/	2
Kallëzime Penale	/	/	/	/
Ftesë nga Prokuroria	/	/	/	/
Padi	/	/	/	/
Përgjigje në Padi	/	/	/	/
Tërheqje e Padive	1	/	/	1
Ekspertizë në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Ekspertizë në dëm të Kompanisë	/	/	/	/
Revizion	/	/	/	/
Përgjigje në Revizion	/	/	/	/
APELI	/	/	/	/
Aktgjykim në favor të kompanisë	/	/	/	/
Aktgjykim kundër kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime në favor të kompanisë	/	/	/	/

Aktvendime kundër kompanisë	/	/	/	/
Ankesa	3	1	/	4
Përgjigje në Ankesë	/	/	/	/
Konkluzione të ndryshme	/	4	/	4
Konkluzione për njoftime të gjykatave	/	/	/	/
Njoftime dhe Kërkesa	/	/	/	
Urdhëresë për pagesë të Garancisë	/	/	/	/
Ujdi Gjyqësore	/	/	/	/
Pagesë të Taksës Gjyqësore	/	1	/	1

PADITË KUNDËR KOMPANISË
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

Nr.	C.nr.	Emri i paditesit	Kontesti	Vlera në €	Vërejtje
1	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Xhezair Bajrami	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Fadil Kastrati	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3	A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017	Arieta Zengin	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
4	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Islam Shala	Padi – kompensim dëmi	1,170.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren (Qepet)
5	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Enver Hoxha	Padi – kompensim dëmi	3,200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë (Trafoja)

6	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Pashk Jak Boqaj	Padi – Kontest pronësor	500.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
7	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Ramadan Bajrami	Padi – Kontest pronësorë	10,000.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
8	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Vellezerit Salihi - Mushtisht	Padi – Kontest pronësorë	3,200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
9	P. 512/18 (10.10.2019)	KEK Pompa e ujit- Savorë- Suharekë	Aktakuzë – lëndime të lehta trupore	E pa përcaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
10	P.nr. 1053/2018	KEK Topalnicë - Suharekë	Propozim për përmbarrim	2,974.95 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit në Prishtinë
11	P.nr. 1040/2018	KEK	Propozim për përmbarrim	13,335.24 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
12	P.nr. 1010/2018	KEK 560 Brigadfa 123,-Suharekë	Propozim për përmbarrim	11,207.25 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
13	P.nr. 1691/2018	KEK Bunari I- Prizren	Propozim për përmbarrim	583,331.70 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
14	P.nr.1804/2018	KEK Pompa e ujit - Kanbash- Prizren	Propozim për përmbarrim	4,415.06 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
15	P.nr. 1693/2018	KEK Pompa - Vermicë- Prizren	Propozim për përmbarrim	460,849.77 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit në Prishtinë

16	P.nr. 1692/2018	KEK Pompa e ujit - Zhur- Prizren	Propozim për përmbarim	274,592.07 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
17	P.nr. 1688/2018	KEK Mulliri I vjeter- Prizren	Propozim për përmbarim	7,832.98 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
18	P.nr. 1694/2018	KEK Malsia e re- Prizren	Propozim për përmbarim	36,937.28 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
19	P.nr. 1690/2018	KEK Cvilen, Sozi, Nashec- Prizren	Propozim për përmbarim	71,665.41 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
20	P.nr. 1689/2018	KEK Kojush- Prizren	Propozim për përmbarim	22,123.25 €	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
	TOTAL			1,507,334.96 €	

PROCEDURA PËRMBARIMORE

	JANAR	SHKURT	MARS	TOTALI
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	44	42	47	133
PRAPËSIME	9	5	6	20
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	9	5	6	20
MARRËVESHJE	11	11	18	40
TË PËRFUNDUARA	10	6	0	16
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	2	0	0	2
PËRGJIGJE NË ANKESË	0	0	0	0
TËRHEQJE	1	1	0	2
ME PËRFAQËSUES	1	2	2	5

NJËSIA PUNUESE SUHAREKË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	0	0	0	0
PRAPËSIME	0	0	0	0
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	0	0	0	0
MARRËVESHJE	6	1	0	7
TË PËRFUNDUARA	1	3	0	4
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	0	0	0	0
PËRGJIGJE NË ANKESË	0	0	0	0
TËRHEQJE	0	0	0	0
ME PËRFAQËSUES	2	0	0	2
NJËSIA PUNUESE MALISHEVË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	0	0	0	0
PRAPËSIME	2	2	0	4
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	2	2	0	4
MARRËVESHJE	6	7	3	16
TË PËRFUNDUARA	2	4	1	7
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	0	0	0	0
PËRGJIGJE NË ANKESË	0	0	0	0
TËRHEQJE	0		0	0
ME PËRFAQËSUES	0	0	0	0
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	0	0	0	0
PRAPËSIME	0	0	0	0
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	0	0	0	
MARRËVESHJE	1	1	1	3
TË PËRFUNDUARA	1	1	0	2
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	1	0	0	1
PËRGJIGJE NË ANKESË	0	0	0	0
TËRHEQJE	0	0	0	
ME PËRFAQËSUES	0	0	0	0

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë ku një lëndë ka të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, kemi lend me kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit si dhe propozimet për përmbarrim për borxh ndaj Kek-ut.

Si pasojë e paraqitjes së pandemisë COVID19, dhe shpalljes së gjendjes emergjente ne shëndetin publik , me Vendim të Menaxhmentit të Kompanisë nga data 16.03.2020 dhe deri më tani është duke u punuar vetëm në sektorët e domosdoshëm të Kompanisë. Kjo gjendje paraqet ngecje ne procedimin lendeve tek permbaruesit privat pwr konsumatorët me borxh ndaj shërbimeve te ujit.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM1-2020, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbarrim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

V. Raporti i punës së auditorit të brendshëm – TM1-2020

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të parë të këtij viti, gjegjësisht, raport i punës për periudhën kohore janar – mars 2020.

- Fillimisht, gjatë muajit janar, në bazë të procedurave të punës së auditimit, është përgatitur raporti i tremujorit të katërt (TM4/2019) të punës së auditorit të brendshëm. Përmes raportit tremujor, është bërë një përmbledhje e punëve dhe aktiviteteve kryesore të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019, gjegjësisht periudhës kohore tetor – dhjetor 2019.

Njëherit është bërë rishikimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe adresimit të rekomandimeve sipas planeve të veprimit të dhëna nga menaxhmenti.

- Gjatë kësaj periudhe, gjithashtu është përgatitur Raporti Vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin paraprak 2019.

Përmes këtij raporti në formë të përgjithësuar dhe kronologjike, është bërë prezentimi i punës njëvjeçare të auditorit të brendshëm, lidhur me:

- auditimet e realizuara;
- subjektet (departamentet, njësitë, shërbimet etj.) e audituara;
- prezentimi i të gjitha konstatimeve, të gjeturave, rekomandimeve, komenteve,
- rishikimi i rekomandimeve të dhëna, si dhe nivelin e adresimit të rekomandimeve,
- prezentimi i realizimit të caqeve të përcaktuara me plan vjetor të punës për vitin aktual.

- Gjatë kësaj periudhe, në takimin e Komisionit të Auditimit, është aprovuar edhe plani strategjik 2020 – 2022, si dhe plani vjetor i auditimit për vitin 2020.

Në pajtim me planin vjetor të punës, është filluar me realizimin e auditimeve, me çrast është kryer:

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të të hyrave të kompanisë, si dhe
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të shpenzimeve rrjedhëse të kompanisë.
- Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe raportuese, kam qenë i angazhuar edhe në përgatitjen dhe ofrimin e disa të dhënave të kërkuara nga auditorët e jashtëm (ZKA), në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë për vitin 2019, si dhe
- Në bashkëpunim me zyrtarët e financave, është përgatitur Plani i Zbatimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin e pasqyrave financiare, të auditorëve të ZKA-së, për vitin 2018, raport ky i cili është obligativ, sipas akteve dhe procedurave të ZKA-së.

- Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë:

- përgatitja e draftit të raportit të auditimit të procesit të të hyrave – faturimit,
- mbajtja e takimit me subjektin e audituar,
- diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe
- finalizimi i raportit.

-Duhet të theksoj se për shkak të rrethanave të krijuara, konkretisht të pandemisë, si dhe për shkak të kërkesës së Qeverisë së Kosovës, që të punohet me staf esencial, e që edhe tek shumë shërbime brenda kompanisë ka qenë e theksuar, andaj edhe auditimi lidhur me shpenzimet rrjedhëse, ka mbetur në proces, dhe mbetet të realizohet në periudhën në vazhdim.

-Poashtu, për shkak të kësaj situate, ka mbetur që në vijim të bëhet edhe rishimi i adresimit të rekomandimeve të dhëna gjatë TM4 2019.

- Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimit, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave në departamentin e financave, gjegjësisht në shërbimin e kontabilitetit, është kryer:

- në pajtim me dispozitat ligjore,
- është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe
- është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

- Gjatë auditimit, janë konstatuar edhe disa mangësi, ku dhe si zakonisht janë dhënë rekomandime konkrete, të cilat edhe priten të realizohen në vazhdim të vitit.

- Në vazhdim, si aneks të këtij raporti janë bashkangjitur edhe raportet e lartë përmenduar, sikurse:

- Raporti tremujor i punës, për periudhën tetor – dhjetor 2019,
- Raporti Vjetor i punës, për periudhën janar – dhjetor 2019, si dhe
- Raportin e auditimit të realizuar, lidhur me të hyrat e kompanisë.

